



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. prot. 22183

Tiranë, më 6.6 2024

Lënda: Shpallje për vende të lira pune

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Në vijim të shkresës me Nr. Prot.13466, datë 02.04.2024 “Shpallje për vende të lira pune”, ju njoftojmë se Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Tiranë do të shtyjë afatin e dorëzimit të dokumentacionit për vende të lira në kuadër të projektit “Aleanca për zgjerim të shërbimeve të integruara sociale dhe mirëqeverisje në rajonin e Tiranës” mbështetur nga Programi “Local level partnerships to advance social inclusion in Albania”, i financuar nga Bashkimi Evropian për pozicionin si më poshtë:

Operator i autonomisë sociale (4 persona)

Lutemi shpallja bashkëlidhur të publikohet në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Faleminderit për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Lënda: Shtyrje e afatit për dorëzimin e dokumentacionit për vende të lira pune në kuadër të projektit “Aleanca për zgjerim të shërbimeve të integruara sociale dhe mirëqeverisje në rajonin e Tiranës”.

Bashkia e Tiranës në partneritet me fondacionin “Down Sindrome Albania” është duke zbatuar projektin “Aleanca për zgjerim të shërbimeve të integruara sociale dhe mirëqeverisje në rajonin e Tiranës”. Ky projekt mbështetet nga Programi “Local level partnerships to advance social inclusion in Albania”, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Projekti ka si qëllim kryesor të sigurojë përfshirje sociale nëpërmjet shërbimeve të integruara të kujdesit social për personat me aftësi të kufizuara nga familje me vështirësi ekonomike që jetojnë në Tiranë, krahas përmirësimit të kapaciteteve të profesionistëve të fushës së aftësisë së kufizuar dhe institucioneve të pushtetit vendor për rritjen cilësore të shërbimeve, qeverisje të mirë dhe transparencë.

Në kuadër të përmbushjes së objektivave të këtij projekti, Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve të Huaja, kërkon shtyrjen e afatit për aplikimin e ekspertëve, të cilët do të ofrojnë kurset e autonomisë sociale për adoleshentët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, deri në 20 Qershor 2024.

OPERATOR I AUTONOMISË SOCIALE (4 PERSONA)

Kërkesat e përgjithshme për kandidatët:

- a) Të jenë shtetas shqiptarë;
- b) Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerje krimi;
- d) Të mos jenë marrë ndaj tij masa disiplinore apo larguar për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- a) Kërkesë për aplikim
- b) Curriculum Vitae
- c) Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- d) Çertifikatë e përbërjes familjare;

- e) Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- f) Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- g) Fotokopje e librezës së punës.
- h) Raport mjeko-ligjor
- i) Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- j) 2 Fotografi 2.5 x 3.5 cm.
- k) Ofertë financiare (Duke përfshirë TVSH apo taksa);

Përgjegjësitë e ekspertit të autonomisë sociale:

- a) Të përgatisë skedat hyrëse dhe ato përfundimtare për çdo kursant sipas formatit të ofruar nga Bashkia Tiranë si dhe të hartojë raportet përkatëse për çdo skedë të plotësuar;
- b) Të mbajë të dhëna për çdo aktivitet të zhvilluar me të rinjtë;
- c) Të përgatisë materialet e nevojshme për zhvillimin e kursit;
- d) Të mbajë një komunikim javor me prindërit e të rinjve pjesëmarrës.
- e) Të raportojë tek Menaxheri i Projektit të fondacionit “Down Syndrome Albania” dhe pranë stafit të projektit pranë Bashkisë Tiranë.

Metodologjia:

Eksperti do të ofrojë shërbimin e tij 1 herë në javë/ pjesëmarrës për 3-4 orë/ aktiviteti për grupin e tij. Shërbimi do të ofrohet nga eksperti dhe do të mbështetet nga një vullnetar profesionist dhe 2-3 studentë. Ky kurs do të ofrohet në komunitet, kështu që i gjithë procesi është të mësosh duke u përfshirë në aktivitet e planifikuara në komunitet.

Supervizimi dhe trajnimi:

Eksperti do të punoj ngushtë me stafin përgjegjës të Bashkisë Tiranë dhe do të raportoj te stafi përgjegjës i projektit të Bashkisë Tiranë dhe fondacionit “Down Syndrome Albania”.

Para nisjes së shërbimit do të ofrohet një trajnim 2 ditor nga stafi i fondacionit “Down Syndrome Albania” për mbajtjen e skedave dhe organizimin e aktiviteteve pjesë të kurseve.

Periudha e kontratës: 7 muaj

Dorëzimi të dokumentave do të bëhet pranë Bashkisë Tiranë, në adresën Torre Drin, kati i parë, zyra nr. 12, deri në 20 Qershor 2024.